

Skema suplementare për personat që kryejnë funksione kushtetuese dhe punonjësve të shtetit.

a) Ligji nr. 8097, datë 21.03.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, i ndryshuar.

Ndryshimet e Ligjit:

b) Ligji nr. 8500, datë 10.06.1999;

c) Ligji nr. 9061, datë 08.05.2003;

d) Ligji nr. 9827, datë 05.11.2007;

e) Ligji nr. 9990, datë 15.09.2008,

f) Ligji nr. 27/2015.

g) Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.35 datë 22.11.2022

2. Kushtet e përfitimit:

a) Të kenë kryer funksione kushtetuese apo detyrën si punonjës i shtetit, sipas listës që i bashkangjitet VKM nr. 548/2016, i ndryshuar. Funksionet dhe detyrat, janë klasifikuar sipas përcaktimeve në Ligj, pra në dy grupe. Në grupin e parë bëjnë pjesë dy nëngrupe: sipas shkronjës “a” të pikës 8, të nenit 1 të Ligjit dhe shkronjës “b” të pikës 8, të nenit 1 të ligjit. Në grupin e dytë ka katër nëngrupe: sipas shkronjës “a” të pikës 9, të nenit 1 të Ligjit, sipas shkronjës “b” të pikës 9, të nenit 1 të Ligjit, sipas shkronjës “c” të pikës 9, të nenit 1 të Ligjit, sipas shkronjës “d” të pikës 9, të nenit 1, të Ligjit;

b) Të kenë paguar kontribute suplementare, duke filluar nga data 01.04.1996:

- Për personat e grupit të parë/ “a”, “b” 5% të shumës bruto të listëpagesave;
- Për personat e grupit të dytë/ “a”, “b” dhe “c”, 4% të shumës bruto të listëpagesave;
- Për personat e grupit të dytë/ “d”, 3% të shumës bruto të listëpagesave.

3. Cilat janë kushtet sipas përfitimeve, që jepen në bazë të këtij Ligji?

a) Pagesa kalimtare.

Kushtet e përfitimit:

– Të jenë larguar nga funksioni, i cili duhet të jetë klasifikuar në grupin e parë, grupin e dytë, shkronja “a”, sipas përcaktimeve në listën që i bashkëlidhet VKM nr. 548/2016.

Masa e përfitimit:

– Personave të grupit të parë, që përmenden në shkronjën “a” të pikës 8 të nenit 1, pas pas ndërprerjes së funksionit, u jepen tri paga mujore të funksionit dhe pas këtyre pagave

marrin 50 për qind të pagës referuese bruto, për aq kohë sa kanë punuar në funksione të tilla, por jo më shumë se 3 vjet nga momenti i largimit nga ky funksion.

– Personave të grupit të parë, që përmenden në shkrojtën “b” të pikës 8 të nenit 1, pas ndërprerjes së funksionit, u jepen dy paga mujore të funksionit dhe pas këtyre pagave marrin

50 për qind të pagës referuese bruto, për aq kohë sa kanë punuar në funksione të tilla, por jo më shumë se 3 vjet nga momenti i largimit nga ky funksion.

– Personave të grupit të dytë, që përmenden në shkrojtën “a” të pikës 9 të nenit 1, pas ndërprerjes së funksionit, u jepen dy paga mujore të funksionit dhe pas këtyre pagave marrin 40 për qind të pagës referuese bruto, për aq kohë sa kanë punuar në funksione të tilla, por jo më shumë se 1 vit nga momenti i largimit nga ky funksion.

– Në rastet kur përfituesi punësohet, brenda periudhës së përfitimit të pagave të funksionit të fundit apo të pagesës kalimtare, masa e pagesës mbi pagën e re është një kompensim deri në nivelin e pagës referuese të funksionit, por në çdo rast ajo nuk mund të jetë më shumë se paga e funksionit të fundit apo pagesa kalimtare e tij.

b) Pensionet shtetërore suplementare të pleqërisë.

Kushtet e përfitimit :

Për personat e klasifikuar në grupin e parë:

1. Të kenë mbushur moshën 60 vjeç ose para kësaj moshe, kur deklarohet invalid i plotë, sipas ligjit për sigurimet shoqërore të detyrueshme. Duke filluar nga data 1.1.2032, mosha e përfitimit rritet me nga 6 muaj për çdo vit, deri në arrijtjen e moshës 63 vjeç.
2. Të kenë periudha të njohura shërbimi në një nga funksionet e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 8, të nenit 1.
3. Të ketë ndërprerë veprimtarinë ekonomike.

Për personat e klasifikuar në grupin e dytë:

Kushtet e përfitimit për personat e grupit të dytë, sipas këtij ligji, janë:

- a) të kenë kryer 35 vite shërbimi në detyrat ose funksionet e parashikuara nga ky ligj; ose
- b) të kenë arritur moshën për pension pleqërie, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ose
- c) para kësaj moshe, kur deklarohet invalid i plotë, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Personat, të cilët plotësojnë njërin nga kushtet e sipërpërmendura, duhet të kenë ndërprerë veprimtarinë ekonomike.

Masa e përfitimit:

Për personat e klasifikuar në grupin e parë:

– Masa e pensionit shtetëror suplementar është:

a) për Presidentin e Republikës, Kryetarin e Kuvendit dhe Kryeministrin, 25 për qind e pagës referuese, edhe nëse periudha e shërbimit është më e vogël se dy vjet, dhe 5 për qind më shumë për çdo vit shërbimi mbi dy vjet;

b) për grupin e parë, përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 8, të nenit 1, përjashtuar personat e përmendur në shkronjën “a”, të këtij neni, 25 për qind e pagës referuese për 2 vjet shërbim dhe 5 për qind më shumë për çdo vit shërbim mbi këta 2 vjet. Kur këta persona nuk plotësojnë periudhën e shërbimit prej dy vjetësh, përfitojnë pension suplementar të reduktuar në masën 1 për qind të pagës referuese për çdo muaj shërbimi;

c) për grupin e parë, përcaktuar në shkronjën “b”, të pikës 8, të nenit 1, 20 për qind e pagës referuese për 2 vjet shërbim dhe 5 për qind më shumë për çdo vit shërbim mbi këta 2 vjet. Kur këta persona nuk plotësojnë periudhën e shërbimit prej dy vjetësh, përfitojnë pension suplementar të reduktuar, në masën 0,8 për qind të pagës referuese për çdo muaj shërbimi.

Masa e pensionit nuk duhet të jetë më e madhe se:

a) 60 për qind e pagës referuese për personat e grupit të parë, përcaktuar në shkronjën “a”, të nenit 1;

b) 50 për qind e pagës referuese për personat e grupit të parë, përcaktuar në shkronjën “b”, të nenit 1.

Masa e pensionit shtetëror suplementar, plus pensionin e përfituar nga ligji nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk mund të jetë më e madhe se 75 për qind e pagës referuese mesatare të funksioneve.”

Për personat e klasifikuar në grupin e dytë:

– Masa e pensionit shtetëror suplementar në kushtet e nenit 10 është:

a) për personat e grupit të dytë, sipas shkronjës “a”, të pikës 9, të nenit 1 të këtij ligji, 1,5 për qind në vit të pagës referuese, për çdo vit shërbimi;

b) për personelin drejtues të grupit të dytë, sipas shkronjave “b” dhe “c”, të pikës 9, të nenit 1, të këtij ligji, 1,3 për qind në vit të pagës referuese, për çdo vit shërbimi;

c) për personelin specialist të grupit të dytë, sipas shkronjës “d”, të pikës 9, të nenit 1, të këtij ligji, 1,1 për qind në vit të pagës referuese, për çdo vit shërbimi.

Pensioni shtetëror suplementar maksimal, sipas këtij neni, nuk duhet të jetë më i madh se 40 për qind e pagës referuese.

Masa e pensionit shtetëror suplementar, plus pensionin e përfituar nga ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Shqipërisë”, të ndryshuar, nuk mund të jetë më e madhe se 75 për qind e pagës referuese të funksionit.”

Pensioni suplementar familjar

Kushtet e përfitimit:

– Përfitojnë pensione familjare nga personi që vdes dhe që përfitonte ose kishte kushte për pension shtetëror suplementar, sipas këtij Ligji, bashkëshorti pasjetues dhe jetimi, kur kanë plotësuar kushtet për pension familjar, sipas Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar.

Masa e përfitimit:

- Masa e pensionit për bashkëshortin pasjetues është 50% e pensionit që kishte ose i takonte të përfitonte mbajtësi i familjes;
- Masa e pensionit për jetimin është 25% e pensionit që kishte ose i takonte të përfitonte mbajtësi i familjes;
- Kur nuk merret pensioni i parashikuar për bashkëshortin pasjetues, masa e pensionit për jetimin është vetëm 50% e pensionit që kishte ose i takonte të përfitonte mbajtësi i familjes;
- Masa e pensionit suplementar familjar nuk mund të jetë më e lartë se pensioni që kishte ose i takonte të përfitonte mbajtësi i familjes;
- Masa e pensionit shtetëror suplementar, plus pensionin e përfituar nga Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, nuk mund të jetë më e madhe se 75% e pagës referuese të funksionit.

d) Pensionet shtetërore për personat që aksidentohen në shërbim.

Kushtet e përfitimit:

– Kur aksidentohen në shërbim (shërbim-në kuptim të këtij Ligji) dhe deklarohen invalidë të përhershëm, sipas Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar.

Masa e përfitimit:

- Masa e përfitimit është 40% e pagës referuese, pavarësisht nga koha (kohëzgjatja) e punës në funksion a detyrë;
- Masa e pensionit shtetëror suplementar, plus pensionin e përfituar nga Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, nuk mund të jetë më e madhe se 75% e pagës referuese të funksionit.

Aplikimi për përfitim:

Personat e interesuar për të përfituar pagesë kalimtare apo pensione shtetërore suplementare duhet të paraqesin, përmes portalit qeveritar "e-Albania", kërkesën për përfitim, ndërsa dokumentet origjinale dërgohen përmes shërbimit postar pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore ku kanë vendbanimin.

Dokumentacioni:

a) Për përfitimin e pagesës kalimtare:

- Fotokopje të letërnjoftimit elektronik
- Vërtetim të pagës referuese (plotësuar nga punëdhënësi);
- Vërtetim të viteve të shërbimit (plotësuar nga punëdhënësi);
- Librezën e kontributeve suplementare, nese ka;
- Nëse jeni i punësuar, vërtetim nga punëdhënësi i fundit për datën e fillimit të punës dhe pagën që përfitoni;

–b) Për përfitimin e pensionit suplementar të pleqërisë, bashkëngjitur kërkesës duhet të keni:

- Fotokopje të letërnjoftimit elektronik;
- Vërtetim të pagës referuese (plotësuar nga punëdhënësi);
- Vërtetim të viteve të shërbimit (plotësuar nga punëdhënësi);
- Librezën e kontributeve suplementare nese ka;

Si bëhet aktualizimi i këtyre përfitimeve:

Pensionet shtetërore suplementare indeksohen. Koha dhe masa e indeksimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.